



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Relacion mbi ecurinë dhe monitorimin e Buxhetit AZHBR viti 2024

Raportimi dhe ndjekja e buxhetit vjetor është kryer në mbështetje të Ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2024”, si dhe zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 24.01.2024 “ Për zbatimin e buxhetit 2024”, Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”,

1. Aktivitetet e shpenzimeve buxhetore

Drejtoria e Financës pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor gjatë periudhës Janar- Dhjetor të vitit 2024, ka ndjekur në vazhdimësi realizimin e shpenzimeve buxhetore, për llogaritë ekonomike 600, 601, 602, 606 dhe 231.

Shpenzimet e fondeve buxhetore për artikujt 600, 601, 602, 606, 231, krahasuar me planin vjetor, janë realizuar konkretisht:

1.1 Shpenzime Personeli (600+601)

Fondi i akorduar për shpenzim page personeli nga buxheti i shtetit për vitin 2024 ka qënë 291,000,000 lekë paga dhe 47,850,000 lekë për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Punonjës në organikë të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr. 93, datë 12.06.2024.

Struktura dhe numër punonjës të miratuar 253.

- 39 punonjës nivele drejtues,
- 206 specialiste të lartë,
- 8 nënpunës të thjeshtë.

Numri i punonjësve në organikë fakt;

- në organikë 220 punonjës,
- mbi organikë 17 punonjës.

Çelja e fondit të pagave në fillim të vitit ishte në vlerën 280,000,000 lekë, ndërsa fondi i sigurimeve në shumën 47,650,000 lekë.

Fondi i akorduar për shpenzim page personeli nga buxheti i shtetit për vitin 2024 ka mbuluar shpenzimet në zërat 600 dhe 601.

Realizimi për 12 mujorin;

- për llogarinë 600 është në shumën 287,800,709 lekë ose 99%
- për llogarinë 601 është në shumën 46,537,436 lekë ose 97%

1.2 Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera (602)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2024 për shpenzimet operative është në vlerë në total 129,009,000 lekë, fond për përmbushjen e nevojave dhe objektivave të AZHBR.

Çelja në zërin 602 në fillim viti ishte në vlerën 146,557,000 lekë. Janë likujduar të gjitha kontratat dhe realizimi vjetor i shpenzimeve operative është në shumën 121,951,926 lekë (95%).

1.3 Transferta në buxhetet familjare (606)

Në kuadër të implementimit të masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2024 dhe fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 2024, VKM Nr. 130, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024” si dhe me udhëzimin Nr. 6, datë 07.03.2024 të MBZHR dhe MFE, (i ndryshuar) buxheti në dispozicion për vitin 2024 është 5,299,564,400 lekë,

Tabela përmbledhese për llogarinë 606 ku përfshihen dhe shpenzimet për ndihmë ekonomike në rast fatkeqësish dhe shpenzim telefon titullari.

Llogaria Ekonom	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë	2,907,277,845	2,907,131,878
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (nafta)	2,291,600,000	2,282,499,947
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (investime)	100,000,000	11,449,415
6061041	Ndihmë e menjëhershme për raste sëmundje e fatkeqësi, etj	180,000	180,000
6061051	Ndihme e menjëhershme financiare për punonjësit	471,400	471,400
6061099	Te tjera transferta tek individët (rimbursim telefoni)	35,155	35,155
	Shuma 606	5,299,564,400	5,201,767,795

Të dhëna për skemën kombëtare 2024 mbi numrin e aplikimeve dhe përfituesve sipas gjinisë.

Numri dhe ndarja sipas gjinisë mbi aplikimet për skemat Direkte është:

- 7993 aplikime të kryera nga gjinia Femërore
- 61,825 aplikime të kryera nga gjinia Mashkullore

Numri dhe ndarja sipas gjinisë mbi përfituesit për skemat Direkte është:

- 5,043 përfitues të gjinisë Femërore (skema e naftës)
- 47,152 përfitues të gjinisë Mashkullore (skema e naftës)
- 2,425 përfitues të gjinisë Femërore (masa 1-7)
- 12,512 përfitues të gjinisë Mashkullore (masa 1-7)

Total numri i përfituesve:

- 7,468 përfitues të gjinisë Femërore
- 59,664 përfitues të gjinisë Mashkullore

Më poshtë janë paraqitur numri i aplikimeve, i përfituesve dhe fondi i paguar sipas masave për vitin 2024.

Nr.	Emërtimi i masës	Nr. Aplikimesh	Nr. Përfitues	Fondi i Paguar
1	Masa 1. Për tufën bazë të matrikulluar Lopë	3,810	3,442	726,047,498
2	Masa 2. Për tufën bazë të matrikulluar Dele/Dhi	5,429	5,087	1,203,793,400
3	Masa 3. Për Bletari	4,323	4,056	417,231,500
4	Masa 4. Për fara/fidane dhe inpute te tjera	556	464	231,433,100
5	Masa 5. Bimë mjekësore dhe aromatike	945	733	143,289,720
6	Masa 6. Për Ferma Organike	169	105	16,800,000
7	Masa 7. Global GAP	48	3	1,060,185
8	Grup Fermer & SHBB	313	1,047	178,192,840
9	Masa 8. Naftë	54,225	52,195	2,282,499,947
Totali		69,818	67,132	5,200,348,190

1.4 Investime Financimi i Huaj

Shpenzimet Kapitale për zërin IPARD II me financim të brendshëm (25%) janë realizuar në vlerë 151,902,010 lekë ose 100% të totalit të Buxhetit për këtë zë investimi.

Shpenzimet Kapitale me financim të huaj (75%) janë realizuar në vlerë prej 377,875,514 lekë ose 99% të totalit të vlerës së Buxhetit çelur për këtë zë investimi.

Në total buxheti i realizuar për IPARD II, çelja nga buxheti (25%) dhe fondi BE (75%), është realizuar në masën 99% të totalit të vlerës për 2024.

Në total për vitin 2024 janë kryer 40 pagesa, me vlerë totale 503,778,528 lekë, për subjekte që kanë përfunduar investimin të ndara si më poshtë:

- **Sipas Masës dhe Sektorit:**

- **MASA 1** janë kryer **16** pagesa, 9 në sektorin e fruta perimeve, 1 në sektorin e Mishit, 4 në sektorin e qumështit dhe 2 në sektorin e vreshtarisë.
- **MASA 3** janë kryer **2** pagesa, në sektorin e përpunimit të fruta-perimeve.
- **Masa 7** janë kryer **19** pagesa, të gjitha në sektorin e turizmit rural.
- **Masa 9** janë kryer **3** pagesa në Sektorin e Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale.
- **Sipas gjinisë sa:**
 - Femra: 11 perfitues
 - Meshkuj: 26 perfitues
- **Sipas moshës sa nen moshen 40 dhe sa mbi 40:**
 - 19 perfitues fermerë të rinj nën 40 vjeç
 - 18 perfitues mbi 40 vjeç

Programi IPARD ka sjellë një transformim rrënjësor në zhvillimin e bujqësisë shqiptare e proceseve prodhuese e përpunuese në vendin tonë, duke u përkthyer në shifra të rëndësishme përsa i përket zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi, rritjes së vendeve të punës, eksporteve, dhe zhvillimit rural në veçanti, duke bërë që rezultatet e implementimit të këtij programi t'i ndejnë jo vetëm prodhuesit dhe agropërpunuesit që kanë përfituar drejtpërdrejtë nga grantet, por edhe gjithë zonat rurale ku këto investime janë ngritur dhe janë të prekshme.

Tab. 2: Realizimi IPARD II 25% dhe 75% për vitin 2024

Llogaria	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
2310000	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm (25%)	152,554,000	151,902,010
2310000	Shpenzime Kapitale me financim te huaj (75%)	381,500,000	377,875,514
	Shuma	534,054,000	529,777,524

Shpenzimet e fondeve buxhetore për artikujt 600, 601, 602, 604, 606, 231, krahasuar me planin vjetor, janë realizuar konkretisht:

Për vitin 2024 në llogarinë 231 është akorduar vlera 6,100,000 lekë për zërin “Blerje paisje kompjuterike AZHBR”, ky zë është realizuar në vlerën 6,084,720 lekë ose 100% të totalit të Buxhetit.

Përmbledhja e të gjithë zërave kryesore të shpenzimeve të AZHBR viti 2024.

Llogaria Ekonom.	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
6001001	Paga, shpërblime dhe tjera shpenzime personeli	291,000,000	287,800,709
6010100	Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	47,850,000	46,537,436
6020000	Shpenzime Operative (Mallra dhe shërbime gjithsej)	129,009,000	121,951,929
6060099	Transferta për Buxhetet Familjare & Individ	2,907,277,845	2,907,131,878
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (nafta)	2,291,600,000	2,282,592,198
6060099	Skemat e mbështetjes për bujqësinë (investime)	100,000,000	11,449,415
6061041	Ndihmë e menjëhershme për raste sëmundje e fatkeqësi, etj	180,000	180,000
6061051	Ndihme e menjehershme financiare per punonjesit	471,400	471,400
6061099	Te tjera transferta tek individët (rimbursim telefoni)	35,155	35,155
2310000	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	152,554,000	151,902,010
2310000	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	381,500,000	377,875,514
2310000	Blerje paisje kompjuterike AZHBR	6,100,000	6,084,720
	Totali	6,307,577,400	6,194,012,364